



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 59, date 28.12.2020

Për dhënien e titullit “Mirënjohje e Bashkisë Shkodër”, Z Hamit Boriçi

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, me propozim të unionit të gazetarëve shqiptarë, mbështetur në nenin 54 shkronja “m”, neni 55 pika 2, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, VKB nr.61, datë 30.11.2016 “Për miratimin e rregullores”Për titujt vendorë të nderit në Bashkinë Shkodër, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre”, me 31 vota Pro

V E N D O S I:

1. Dhënien e titullit “Mirënjohje e Bashkisë Shkodër” për Z.Hamit Boriçi, me motivacionin:

“Për kontribute të vlefshme në fushën e kërkimit shkencor; si gazetar, pedagog, studiues, themelues i pjesës më të madhe të katedrave të gazetarisë shqiptare dhe nismëtar në realizimin e studimeve dhe hartimin e teksteve shkencore në fushën e gazetarisë dhe publicistikës shqiptare dhe ndër të paktët historianë të gazetarisë shqiptare”

2. Për zbatim e këtij vendimi ngarkohet sekretaria e këshillit bashkiak.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretar i Këshillit


Denis Lesha

KRYETARE

